



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 148 Prot.
/ 5

Tiranë, më 16 / 06 / 2022

URDHËR

Nr. 44, datë 16 / 06 / 2022

**“PËR PEZULLIMIN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,
NOTERIT [REDAKTUAR]”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteri [REDAKTUAR], i cili e ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 441 datë 01.08.2014, në Rrethin Gjyqësor Lushnje, nëpërmjet shkresës me nr. E-148 prot., datë 19.05.2022, ka paraqitur kërkesën e tij për pezullimin e licencës së noterit, me një kohëzgjatje 8 mujore, për arsye shëndetësore.

Bashkëlidhur kërkesës së tij z. [REDAKTUAR] ka dorëzuar dokumentacionin mjekësor, duke parashtruar se prej më shumë se 3 vitesh vuan nga disku degjenerativ i kolonës vertebrale. Pavarësisht trajtimit me fizioterapi, regjim dhe qetësues, si pasojë edhe e qëndrimit ulur me orare të zgjatura prej profesionit të tij, kjo gjendje është bërë konstante dhe pa asnjë përmirësim.

Në këto kushte, duke qenë se gjendja e tij fizike është e rikuperueshme, me qëllim kurimin e mëtejshëm sipas nevojave shëndetësore, noteri kërkon të pezullojë licencën për ushtrimin e profesionit të noterit për një periudhë 8 mujore. Në lidhje me administrimin e arkivit të tij noterial gjatë kësaj periudhe kohore, noteri propozon t’ia kalojë noterit [REDAKTUAR], me dakordësi nga ana e tij.

Bazuar në pikën 3, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës”, Dhoma Kombëtare e Noterisë, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë nesh me nr. E-148/1 prot., datë 06.06.2022, shpreh miratimin për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë noteriale të noterit [REDAKTUAR] për periudhën e sipërcituar.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, noteri [REDAKTUAR] gjendet përpara parashikimeve të nenit 18, pika 1 sipërcituar, pra përpara rastit kur noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet

përkohësisht, për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të gurmës "a", pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e përkohshëm të licencës së ushtrimit të profesionit të noterit [REDAKTUAR], anëtar i Degës Vendore të Noterisë Vlorë, për periudhën kohore 8 muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, për arsye shëndetësore;
2. Caktimin e noterit [REDAKTUAR] për administrimin e arivës noteriale, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën I të këtij urdhri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. [REDAKTUAR], specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. [REDAKTUAR], specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Vlorë.
4. Lënien në ruajtje të vulave respektive, vulën e thatë dhe vulën e njomë, të noterit [REDAKTUAR], deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës;
5. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit menjëherë pasi të njihet me këtë urdhër, të caktoj datën dhe orën e dorëzimit të arkivit, si dhe të njoftoj noterin z. [REDAKTUAR] 5 (pesë) ditë përpara për datën dhe orën e caktuar.
6. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
7. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

?

8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjëve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
10. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

